



LAPSI.al

Sherr i ashpër mes bashkëshortëve në Bathore, parandalohet vrasja e gruas

16/08/2019,
12:30



Përshkallëzimi i një konflikti të ashpër mes një çifti bashkëshortësh, banues në Kamëz, është mundur të parandalohet në kohë, duke shmugur kryerjen e një krimi brenda familjes.

Është arrestuar në flagrancë shtetasi me initiale R.S., 60 vjeç, të cilit iu gjetën dhe iu sekuestruan nga kontrolli në banesë, një armë zjarri

automatik me qytë druri, 2 karikatorë dhe 96 fishekë, që dyshohet se do të përdoreshin prej tij për të vrarë të shoqen.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, dhe “Dhuna në familje” në ngarkim të shtetasit R. S.

[#bathore](#)[#krim ne familje](#)[#sherr mes bashkeshorteve](#)